



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 17.02.2016

PËR

ZBATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE NGA AUTORITETET
VENDORE TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Në zonat sipas pikës a), të nenit 45, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit të vijojnë me hartimin e planeve të detajuara vendore dhe shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, sipas kushteve zhvillimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e miratimit të planeve të përgjithshme vendore mbi të cilat bazohen.
2. Ky vendim do të zbatohet deri në miratimin e Planeve të reja të Përgjithshme Vendore, sipas ndarjes administrativo - territoriale bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ngarkohen Autoritetet Vendore të Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT